

VENDIM
Nr. 180, datë 20.8.2018

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “ALESIO–2014” SHPK, NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “FUSHË-ARRËZ”, ME FUQI
TË INSTALUAR 1990 kw**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, nenit 4, pika 1, germa “a”, nenit 5, pika 1, germa “a” dhe nenit 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, dhe nenit 15, të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.8.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut mbi licencimin e shoqërisë “Alesio–2014” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 143, datë 25.6.2018, ka filluar procedurën për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Alesio–2014” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Fushë-Arrëz”, me fuqi të instaluar 1990 kw.

- ERE, me shkresën nr. 55/38 prot., datë 26.6.2018, ka bërë njoftimin në media për fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit.

- ERE, me shkresën nr. 420/1 prot., datë 28.6.2018, i ka kërkuar subjektit plotësimin e dokumentacionit të munguar ose jo të plotë, që konsistonte në:

- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor. Neni 9, pika 2, germa “d” të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” (rifreskimi i vërtetimit nga Prokuroria dhe Gjykata);

- dokumentacioni financiar dhe fiskal. Neni 9, pika 3, germa “a”, të Rregullores sipërcituar (vërtetimi për shlyerjen e tatim-taksave). Neni 9, pika 3, germa “c”, të Rregullores sipërcituar (dokumente që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit);

- dokumentacioni teknik për HEC-in. Neni 9, pika 4.1.3, germa “b” të Rregullores sipërcituar (një diagram elektrik në format A1 të aggregateve dhe bllokut të transformimit ku të evidentohen qartë pika e lidhjes me sistemin dhe pika e matjes).

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 420/3 prot., datë 7.8.2018, subjekti “Alesio 2014”, ka përcjellë në ERE të gjithë dokumentacionin e kërkuar.

- Në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, nuk rezultojnë të ketë vërejtje apo ankesë nga palë të treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “Alesio–2014” sh.p.k.

- Në përfundim të shqyrtimit, rezultojnë se aplikimi i shoqërisë “Alesio–2014” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”.

- Kontrata nr. 986 rep. dhe nr. 431/2 kol., datë 9.5.2018, e lidhur ndërmjet shoqërisë “Alesio–2014” sh.p.k., në cilësinë e mbajtësit të miratimit dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë parashikon një kohëzgjatje prej 49 vjetësh. Neni 38, pika 1, germa “a”, i ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, parashikon se afati i vlefshmërisë së licencës për veprimtarinë e prodhimit, nuk mund të jetë më shumë se 30 vjet. Neni 5, pika 1, germa “a” i “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, parashikon se kohëzgjatja e vlefshmërisë së licencës për prodhimin e energjisë elektrike është deri në 30 vjet.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Alesio–2014” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Fushë-Arrëz”, me fuqi të instaluar 1990 kw, për një afat 30-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti